



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.30/2018
Prishtinë, më 12.6.2018, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë dhe Memli Krasniqi, anëtar.

I ftuar: z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik – MZHE;
z. Arsim Berisha, kryesues i Bordit të Autoritetit Rregullator Hekurudhor – ARH.

Pjesëmarrës të tjerë: Lulzim Demolli, Shkumbin Asllani, Halit Hoxhaj – MZHE; Qerkin Berisha – Projekti i BE-së; Shkumbin Hysenaj, Ilmi Ahmeti, Shkëlzen Qorri – ARH; Dardan Abazi – INDEP, Liridon Gashi – SEEF, Dren Ajeti – Klubi i prodhueseve; Donika Osmani “Ekonomia online”, Aurora Buçaj - KDI.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.6.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave – ARH për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.6.2018

Procesverbali i mbledhjes së datës 1.6.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-079 për efijencë të energjisë

Kryetarja, theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës, është ftuar z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, me bashkëpunëtorë, që të prezantojë në parim, para komisionit, Projektligjin për efijencën e energjisë dhe ia dha fjalën ministrit.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, gjatë prezantimit, theksoi se ky projektligj është hartuar, duke marrë për bazë direktivat dhe të gjitha standardet e BE-së në fushën e efijencës së energjisë. Me këtë projektligj përcaktohen objektivat e Republikës së Kosovës, sa i përket efijencës së energjisë, themelohet Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Efijencën e Energjisë, përcaktohet struktura dhe përmbajtja e planeve për efijencë të energjisë, përcakton palët e obliguara edhe në sektorin privat. Ai potencoi se ky projektligj është hartuar me ndihmën e projektit të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe janë konsultuar të gjitha palët e interesit. Përveç kësaj, për tekstin e projektligjit është konsultuar edhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe janë marrë për bazë vërejtjet dhe sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtarë të kësaj fushe. Ai, në vazhdim, theksoi se Ministria e Financave ka dhënë një mendim pozitiv, sa i përket vlerësimit të ndikimit financiar të këtij projektligji. Kosova do të përfitojë rreth 10 milion euro në formë granti, me hyrjen në fuqi të këtij projektligji. Projektet do të implementohen përmes Fondit për Efijencë të Energjisë, i cili themelohet me këtë projektligj. Në fund të prezantimit, ai kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të miratohet projektligji dhe shtoi se MZHE do të jetë e gatshme që në fazat e mëtejme të punojë me komisionin, për të shqyrtuar dhe plotësuar këtë projektligj në fazat tjera të miratimit.

Hykmete Bajrami, pyeti: Si do të financohet Fondi për Efijencë të Energjisë? Çka do të ndodhë me sektorin privat, sepse sektori privat shpenzon 70% të energjisë elektrike? Ne kemi në shqyrtim projektligjin për produktet e ndërtimit dhe materialet për produkte të ndërtimit, a duhet t' i nënshtrohen kërkesave për efijencë të energjisë?

Mimoza Kusari – Lila, theksoi se projektligji ka vonesa, siç shihet nga afatet e vendosura në projektligj. Lidhur me këtë, pyeti: Çka do të ndodhë me këto afate? Afati për strategjinë është 30 qershor 2018, deri ku keni arritur me hartimin e këtij dokumenti? Ku mbështetet baza juridike e themelimit të fondit dhe kush është themelues në Republikën e Kosovës? Pse për anëtarë të Bordit të Fondit, thuhet të mos jenë të emëruar politikë, ndërsa në bord caktohen përfaqësues të ministrive relevante, pa ndonjë procedurë të konkurrimit? Ajo potencoi se nëse nuk kemi zbatim të plotë të marrëveshjes me Serbinë për energji, është vështirë të zbatohet Ligji për Efijencë të energjisë dhe të arrihet caku për energjinë e ripërtëritshme. Pse në bord nuk janë të përfaqësuar komunat nëpërmjet Asociacionit të Komunave të Kosovës?

Gani Dreshaj, pyeti: Pse po shkojmë kah themelimi i fondeve? Sipas tij, do të ishte shumë më mirë të themelohet një bankë zhvillimore, siç e ka edhe Gjermania.

Valdrin Lluka, ministër, duke u përgjigjur në pyetje, tha se si model për fondin e kemi marrë Fondin për Garanci Kreditore, sepse nuk kemi pasur ndonjë model tjetër. Sa i përket produkteve të ndërtimit, në procedura të ndërtimit për objekte publike, duhet të aplikohen masat efiçiente. Ligji për efiçencë të energjisë është çështje e brendshme dhe nuk ndërlidhet me cakun për burime të ripërtëritshme. Rreth 30 milionë janë duke u futur në ndërtesa publike, si pjesë e projekteve për efiçencë të energjisë. Fillimisht, fondi do të zbatohet në objekte publike, mandej do të shohim më vonë mundësitë edhe për sektorin privat.

Qerkin Berisha, projekti i BE-së për MZHE, theksoi se model për fondin është marrë Fondi për Garanci Kreditore. Themelues i fondit është Republika e Kosovës, të cilën e përfaqëson Qeveria.

Hykmete Bajrami, potencoi se Fondi për Garanci Kreditore është themeluar me ligj të veçantë. Ajo shprehu brengosje, nëse do të adresohen me Ligjin për efiçencë të energjisë, të gjitha çështjet rreth fondit. Ajo pyeti: Sa e keni menduar që Fondi për Efiçencë të Energjisë të themelohet me ligj të veçantë?

Kryetarja tha se në bazë të ligjit, fondi targeton vetëm pjesën publike.

Halit Hoxhaj, MZHE, sqaroi se planet komunale janë duke u përgatitur me ndihmën e GIZ-it. Afatet që janë vendosur në projektligj rrjedhin edhe prej ligjit në fuqi dhe janë pjesë e marrëveshjes së Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Për të themeluar fondin me ligj të veçantë, është menduar në ministri, por për shkak të presionit kohor për përfitimin e donacioneve nga IPA, në vlerë prej 10 milionë eurosh, themelimin e fondit e kemi përfshirë në Projektligjin për efiçencë të energjisë.

Pas debatit, komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-079 për efiçencë të energjisë;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë, në parim, Projektligjin nr. 06/L-079 për efiçencë të energjisë;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.*

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave – ARH për vitin 2017

Kryetarja, theksoi se sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2017. Të pranishëm për prezantimin e raportit, janë anëtarë të bordit dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të këtij autoriteti. Në vazhdim, kryetarja ia dha fjalën kryesuesit të Bordit të ARH-së, z. Arsim Berisha, që të prezantojë raportin.

Arsim Berisha, kryesues i Bordit të ARH-së, duke prezantuar raportin, theksoi se ARH, si agjenci e pavarur, ushtron funksionin e vet, në bazë të Ligjit të hekurudhave të Kosovës 04/L-63. ARH, që ka mision rregullimin, mbikëqyrjen dhe organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës. Ai njoftoi se gjatë vitit 2017, ARH ka nxjerrë vendimin për ndaljen e operimit të trenave ilegale në Kosovë. Në këtë vit, kemi edhe fillimin e operimit të operatorit privat hekurudhor, i pari në rajon. ARH ka regjistruar dhe ka inspektuar mjetet hekurudhore me pronësi të padefinuar e të cilat gjenden në Kosovë. Po ashtu, ARH së bashku me operatorët hekurudhorë dhe MZHE-në, ka përpiluar edhe listën e mjeteve hekurudhore kosovare që nuk gjenden në territorin e Kosovës. ARH, gjatë këtij viti, ka pasuruar legjislacionin sekondar me 8 rregullore të reja, të cilat janë kompatible me rregulloret e BE-së. ARH, në aspektin e përfaqësimit ndërkombëtar, ka vazhduar me angazhimin maksimal, që të përfaqësohet sa më denjësisht. Rrjedhimisht, me përfaqësim zyrtar, anëtarësim dhe pjesëmarrje, sistemi hekurudhor në Kosovë, është më mirë se vendet fqinjë. Në fushën e sigurisë, ARH ka kryer inspektimet e nevojshme, në bazë të ligjit dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme. Siguria në hekurudha, përveç nga vendkalimet ilegale dhe nga mungesa e mbrojtësve, përgjatë linjës hekurudhore, në raste të caktuara po cenohet edhe nga ndërtimet, për të cilat komunat përkatëse duhet të jenë më të kujdesshme. Ndër sfidat tjera, z. Berisha potencoi nevojën imediate për ndryshimin e legjislacionit aktual, kapacitetet jo të mjaftueshme kadrovike në ARH, pavarësia jo e plotë financiare e ARH, mbikëqyrja e procesit të përgatitjes profesionale të makinistëve dhe miratimi i TSI-ve, që janë rregulla të BE-së që përcaktojnë kriteret teknike, që duhet të plotësojnë sistemet dhe nënsistemet hekurudhore.

Gani Dreshaj, pyeti: Cilat kompani janë të interesuara të investojnë në Kosovë? Si është situata në sigurinë hekurudhore?

Shkumbin Hysenaj, ARH, sqaroi se në transportin hekurudhor të mallrave operon vetëm një kompani private “Rail Trans”.

Hykmete Bajrami, theksoi se ndërmarrjet publike “Trainkosi” dhe “Infrakosi” kanë probleme buxhetore. Si ka ndikuar hyrja e operatorit privat në të hyrat e ndërmarrjes publike “Trainkos”? Pse i keni futur konkurrencë ndërmarrjes publike, derisa ajo subvencionohet nga shteti? U tha se dy kompani kanë shprehur interesim për me investuar në sektorin hekurudhor, çka nënkupton ky investim?

Mimoza Kusari – Lila, pyeti: Cili është roli i ARH-së në investimet për zgjerimin e rrjetit hekurudhor, që parashihet të rregullohet?

Shkumbin Hysenaj, ARH, sqaroi se kur flitet për investitorë në sektorin hekurudhor nënkupton futjen e operatorëve transportues hekurudhorë. Lidhur me investimet në zgjerimin e rrjetit hekurudhor nga Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Leshak. Ne, si ARH, kemi informacion vetëm aq sa jepet në media, nuk jemi të përfshirë në procesin e investimeve në hekurudha. Sa i përket sigurisë, janë 85 vendkalime legale, pa mbrojtëse. Po ashtu, vendkalime ilegale po hapen vazhdimisht, madje kjo po ndodh edhe nga komunat gjatë ndërtimit të rrugëve të reja.

Ilmi Ahmeti, ARH, theksoi se ne jemi përcaktuar për ekonomi të tregut dhe ne na obligon ligji për të licencuar edhe operatorë tjerë transportues hekurudhorë të mallrave, nëse ka kërkesa. Në

investime të infrastrukturës hekurudhore nuk kemi qasje. Ne, si ARH, jemi të fokusuar në licencim dhe siguri hekurudhore.

Hykmete Bajrami, potencoi se ekonomia e tregut nuk thotë që të fusë konkurrencë ndaj operatorit publik, derisa as në vendet e rajonit dhe as në shumë vende perëndimore nuk ka operatorë privatë në hekurudha.

Bilall Sherifi, tha se qëllimi për të licencuar më shumë se një operator është për ta ulur çmimin e transportit, por edhe duhet të kujdesemi që ta mbrojmë operatorin publik.

Pas debatit, komisioni, me 5 vota “për” dhe 1 “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave (ARH) për vitin 2017;*
- II. I rekomandohet Kuvendit që ta miratojë Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave (ARH) për vitin 2017;*
- II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

**5. Të ndryshme
Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA